

# RAPORTI TREMUJOR 2026

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 1414 Më 07. du 20 26  
Br. prot. Dt. 07. du 20 26  
RAHOVEC - ORAHOVAC

**KOMUNA E RAHOVECIT**  
**PERIUDHA: JANAR – MARS 2026**

---

---

**Tabela e përmbajtjes**

<b>HYRJE.....</b>	<b>3</b>
<b>ORGANIZIMI I PUNËS .....</b>	<b>3</b>
<b>OBJEKTIVAT E INSPEKTIMIT.....</b>	<b>3</b>
<b>AKTIVITETET SIPAS FUSHAVE .....</b>	<b>3</b>
<b>4. TABELAT E TË DHËNAVE .....</b>	<b>4</b>
<b>5. GRAFIKËT .....</b>	<b>5</b>
<b>PËRFUNDIM.....</b>	<b>5</b>

### HYRJE

Ky raport paraqet një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve dhe angazhimeve të Drejtorisë për Punë Inspektuese për tremujorin e parë të vitit 2026. Raporti përfshin veprimtarinë inspektuese të zhvilluar në të gjithë territorin e Komunës së Rahovecit, duke reflektuar rezultatet e arritura në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Qëllimi kryesor i inspektimeve ka qenë sigurimi i respektimit të ligjeve dhe rregulloreve komunale, mbrojtja e interesit publik, garantimi i kushteve të drejta për zhvillimin e veprimtarive ekonomike, si dhe ruajtja e shëndetit dhe sigurisë së qytetarëve.

### ORGANIZIMI I PUNËS

- Inspektimet kryhen nga **4 grupe të kombinuara inspektuese**.
- Organizimi mbulon gjithë territorin e komunës.
- Inspektimet në terren zhvillohen kryesisht nga ora **09:00 – 14:00**, me mundësi zgjatjeje sipas nevojave.

---

### OBJEKTIVAT E INSPEKTIMIT

Qëllimet kryesore të inspektimit janë:

- ✓ Respektimi i ligjeve dhe akteve nënligjore;
- ✓ Këshillimi i subjekteve për zbatimin korrekt të normave ligjore;
- ✓ Marrja e masave parandaluese dhe ndëshkuese;
- ✓ Shqiptimi i gjobave dhe masave administrative.

### AKTIVITETET SIPAS FUSHAVE

#### Inspektorati i Ndërtimit

Gjatë kësaj periudhe është vendosur fokus i veçantë në parandalimin dhe ndalimin e ndërtimeve pa leje:

- Janë evidentuar dhe ndërprerë punimet në raste të ndërtimeve pa leje ;
- Janë lëshuar vendime për rrënim në rastet e mosrespektimit të urdhrave ;
- Është realizuar mbikëqyrje e vazhdueshme e standardeve të ndërtimit ;
- Janë shqiptuar dhe ekzekutuar **36 gjoba mandatore**.

#### Menaxhimi i Hapësirave Publike

- Janë identifikuar subjektet që shfrytëzojnë hapësirat publike pa leje;
- **37 subjekte** janë obliguar të pajisen me leje përkatëse
- **17 subjekte** kanë përmbushur obligimet, ndërsa 20 të tjerë janë në proces , gjatë javëve në vazhdim do të obligohen të gjithë shfrytëzuesit e hapësirave publike të pajisen me leje në të kundërtën do merren masa ndëshkuese .

### **Inspektorati i Tregut dhe Ekonomisë Informale**

- Janë intensifikuar kontrollet ndaj aktiviteteve ekonomike, si rezultat, **27 biznese** janë formalizuar dhe regjistruar;
- Janë lëshuar **15 pëlqime pune** për subjektet që plotësojnë kushtet ;
- Janë kontrolluar **30 biznese** për respektimin e çmimeve dhe deklarimit të produkteve;
- Janë shqiptuar 8 gjoba mandatore për mos respektim të orarit të punës.

### **Inspektorati i Mjedisit**

- Janë realizuar kontrolle për mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e ndotjes;
- Janë shqiptuar 28 gjoba mandatore për ndotje mjedisi;
- **15 subjekte** janë obliguar të pajisen me leje mjedisore
- Është monitoruar zbatimi i akteve për menaxhimin e mbeturinave dhe automjeteve të vjetra

### **Transporti Publik**

- Është monitoruar funksionimi i transportit publik dhe zbatimi i orareve
- Janë kryer kontrolle ndaj operatorëve dhe autotaksive
- Janë dhënë udhëzime për rinovim të dokumentacionit

### **TRAJTIMI I KËRKESAVE DHE BASHKËPUNIMI**

Drejtoria ka trajtuar në mënyrë efikase kërkesat dhe ankesat e qytetarëve, duke reaguar në kohë për çdo rast të paraqitur.

#### **4. TABELAT E TË DHËNAVE**

##### **4.1 Gjoba Mandatore**

Lloji i ndëshkimit	Numri	Vlera (€)
Ndërtim pa leje	36	9,000
Mjedis	26	2,800
Çështje komunale	7	850
Mosrespektim i orarit të punës	8	400
<b>Totali gjobave</b>	<b>77</b>	<b>13,050</b>


##### **4.2 Pëlqime pune & Kërkesa për kontroll**

Veprimi	Numri	Vlera (€)
Pëlqime pune	12	180
Kërkesa për kontroll inspektues	7	70
<b>Totali</b>	<b>19</b>	<b>250</b>

**TOTALI I TË HYRAVE: 13,300 €**

## 5. GRAFIKËT

### 5.1: Gjoha sipas sektorëve



## PËRFUNDIM

*Përkundër të gjitha sfidave, konsiderojmë që jemi në rrugë të mirë për përmbushjen e të gjitha objektivave, sigurisht edhe me një bashkëpunim me të gjitha institucionet tjera të cilat po na ndihmojnë me arritjen e rezultateve konkrete.*

Nora BOSHINJAKU

Drejtoreshë për Punë Inspektuese

